

K O N T R A T E

PER THMELIMIN E SHOQERISE TREGETARE ME PERGJEGJESI TE
KUFIZUAR " B. I. C. "

Sot me dt. ___/___/1993, ne themeluesit z. Adrian Dulaku shtetas shqipatar, banues ne Tirane te Shqiperise Rr. "Qemal Stafa" Pall. 188/1 Shk. 1 Ap. 3, dhe z. Mateo Scalco shtetas italian dhe banues ne Cittadella te Italisë, vendosem te krijojme Shoqerine Tregetare me Pergjegjesi te Kufizuar " B. I. C. " dhe qe me poshte per lehtesi komunikimi do te quhet Shoqeria. Shoqeria krijohet ne baze te legjislacionet shqiptar ne fuqi ne pergjithesi dhe ne vecanti ne baze te ligjit Nr. 7638 dt. 19.11.1993 "Per Shoqerite Tregetare" .

Neni 1

Emertimi i Shoqerise eshte Shoqeria Tregetare me Pergjegjesi te kufizuar " B. I. C. ", dhe veprimtaria e saj eshte e bazuar ne legjislacionin dhe disiplinen shqiptare juridiko-ekonomike si dhe normat e kesaj kontrate dhe statutit qe i bashkengjitet kesaj kontrate dhe eshte pjese e pandare e saj .



Neni 2

Kapitali themeltar i Shoqerise eshte 1.000.000 (nje milion) leke. Kontributi i seicilit ortak ne kapitalin themeltar te Shoqerise eshte respektivisht z. Adrian Dulaku 500.000 leke dhe ortaku z.Mateo Scalco 500.000 leke .

Pjeset respektive te kapitalit themeltar nenshkruhen dhe shlyhen teresisht e plotesisht nga ortaket ne para ose te mira materiale .

Ne asnje rast pjeset e kapitalit nuk mund te perfaqesojne kontribute ne sherbime .

Kapitali themeltar eshte i ndare ne 1.000 pjese me vlere nominale ne nje mase prej 1.000 leke seicila dhe me numur serie nga 1 deri ne 1.000. Z.Adrian Dulaku i takojne pjeset e kapitalit themelor me numur serie nga 1 deri ne 500 ndersa z.Mateo Scalco i takojne pjeset e kapitalit themelor me numur serie nga 501 deri ne 1.000 .

Neni 3

Qendra e Shoqerise eshte ne Tirane Rr."Qemal Stafa" Pall.188/1 Shk.1 Ap.4 por ajo mund te transferohet me vendim unanim te asamblese se ortakeve. Shoqeria mund te cete degje filiale, zyra perfaqesimi, zyra komisionere apo agjensi ne rast nevojiten per realizimin e objektit te vepimitarise se saj, si brenda ashtu dhe jashte territorit te Republike se Shqiperise .



Neni 4

Kohezgjatja e veprimtarise se Shoqerise eshte per nje kohe prej 11 vjetesh kalendarike. Shoqeria mund te shperbehet edhe perpara mbarimit te ketij afati me vendim unanim te asamblese se ortakëve .

Neni 5

Objekti i veprimtarise se Shoqerise eshte si me poshte
- Aktivitetet i importimit dhe eksportimit te leneve te para, prodhimeve te gatshme si direkt ashtu dhe ndermjetesimit tregetar .

- Transport, ndertim te oblakeve te ndryshme sipas porosive te treteve .

- Kryerje e operacioneve te ndryshme tregetare dhe financiare duke perfshire dhe dhenjen e garancive .

- Bashkepunimi me persona fizike dhe juridike te tjera duke krijuar me ta shoqeri tregetare te cdo forme qofte, per te realizuar qellimin e caktuar ne objektin e saj te veprimtarise .

Neni 6

Organi me i larte dhe i vetem vendimor i Shoqerise eshte asamblea e ortakëve te Shoqerise .

Asamblea e ortakëve te Shoqerise zgjedh keshillin administrativ te Shoqerise .

Administratore te Shoqerise jane zoterinjte Adrian

Dulaku dhe Mateo Scalco, te cilet e perfaqesojne Shoqerine ne maredhenjet e saj me te tretet. Administratoret fitojne dhe marrin persiper detyrime ne emer te Shoqerise .



Neni 7

Secili ortak, ka te drejten qe ne cdo kohe te largohet nga Shoqeria, por ai duhet te lajmeroje 30 dite me pare ortakun tjeter .

Neni 8

Secili ortak i Shoqerise do te pergjigjet per fitimet dhe per humbjet e Shoqerise, deri ne vleren e kapitalit htemeltar .

Shoqeria do te ketë librin e saj te llogarise, ne te cilen do te evidentohet aktiviteti tregetar, do te inventarizohen mjetet e punes e te prodhimit, etj. .

Neni 9

Secili ortak pergjigjet individualisht per demet qe mund t'i shkaktoje Shoqerise, si rezultat i veprimeve me dashje apo nga pakujdesia, qe kane sjelle si pasoje nje dem te evidentuar material

Neni 10

Administratoret kane te drejte te punesojne apo te largojne nga puna te punesuarit .



Neni 11

Te gjitha mosmarreveshjet qe do te lindin gjete veprimatrise se Shoqerise, midis saj dhe te treteve, ne rast se nuk do te zgjidhen me mirekuptim te paleve, do te zgjidhen ne Gjykatën e Rethit Tirane .

Neni 12

Kjo kontrate pasi ju lexohet paleve ortakë, te cilet bien dakord per permbajtjen e saj dhe e nenshkruajne ate pa verejtje dhe me vullnetin e tyre te lire .

O R T A K E T

ADRIAN DULAKU

MATEO SCALCO

REPUBLIKA E SHQIPERISE

MINISTRIA E DREJTESISE

NOTERIA Tirane

Nr. 38326 Rep.

Nr. 11472 Kol.

V E R T E T I M

Per sa u tha me siper, une noteria e Turanes z. Cl Sachushi, u hartua nje dokument i cili pasi u lexua

dhe u njoh konform me vullnetin e te siperpermendurve, nenshkrua nga ana e tyre perpara meje, konform ligjit dhe vertetohet prej meje i rregullt .

Tirane, me dt. 22/12/1993



N O T E R E

Alimata Sadiku
[Signature]

S T A T U T
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"B.I.C."



Eshte themeluar nje Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar e quajtur "B.I.C." nga ortaket Adrian Dulaku dhe Mateo Scalco, qe me poshte per lehtesi komunikimi do te quhet Shoqeria .

Neni 1

Emertimi i Shoqerise eshte Shoqeria Tregetare me Pergjegjesi te Kufizuar " B. I. C. ". Shoqeria eshte person juridik shqiptar dhe e ka fituar kete te drejte qe nga dita e rregjistrimit ne Gjykatën e Rrethit Tirane. Aktivitetin e saj Shoqeria do t'a ushtroje ne baze te legjislacionit shqiptar ne fuqi .

Neni 2

Selia e Shoqerise eshte ne Tirane Rr."Gënal Stafë Pall. 188/1 Shk.1 Ap.3 . Ajo mund te krijojë zyra perfaqesimi, agjensi, filiale dhe zyra komisionere si brenda dhe jashte territorit te Shqiperise. Selia e Shoqerise mund te transferohet me vendim te asamblese se ortakëve .



Neni 3

Kohezgjatja e veprimtarise se Shoqerise eshte e fiksuar deri ne vitin 2030 qe nga dita e regjistrimit ne tin 2030 qe nga dita e rregjistrimit te saj ne Gjykatën e Rrethit Tirane. Kohezgjatja e veprimtarise se Shoqerise mund te zvogelohet apo te zmadhohet me vendim te asamblese se ortakëve .

Neni 4

Kapitali themeltar i Shoqeris eshte ne nje mase prej 1.000.000 (nje milion) leke. Ky kapital i perket ortakëve ortakëve Adrian Dulaku dhe Mateo Scalco .

Kontributi i cecilit ortak eshte si me poshte :

- Adrian Dulaku - 50% = 500.000 leke
- Mateo Scalco - 50% = 500.000 leke .

Kapitali ndahet ne nje mije pjese me vlere nominale prej 1.000 leke secila dhe me numur serie nga 1 deri ne 1.000.

Ortakut Adrian Dulaku i takojne pjeset e kapitalit me numer serie nga 1 deri ne 500, ndersa ortakut Mateo Scalco i takojne pjeset e kapitalit me numer serie nga 501 deri ne 1.000 .

Pjeset e kapitalit themeltar jane te shlyeshme dhe te nenshkrueshme plotesisht nga secili ortak .

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te

transferueshme ne rruge trashegimie, midis ortakeve, midis paraardhesve dhe pasardhesve te tyre dhe anasjelltas .

Me vendim te asamblese se ortakeve te Shoqerise. Shoqeria mund t'u shese te treteve pjese te kapitalit te saj themeltar .

Neni 5

Objekti i veprimtarise se Shoqerise eshte si me poshte

- Importi dhe eksporti i lendeve te para, prodhimeve te gatshme, si direkt ashtu dhe ndermjet ndermjatesimit tregetar, ndertimit te objekteve te ndryshme sipas porosise se te treteve .

Kryerja e operracioneve tregetare dhe finanviare duke perfshire dhe dhenjen e garancive .

-Bashkepunimi me persona fizike dhe juridike te tjere, duke krijuar me ta shoqeri tregetare te cdo forme qofte per te realizuar qellimin e caktuar ne objektin e saj te veprimtarise .

Neni 6

Me vendim te asamblese se ortakeve Shoqeria mund te shtoje, te pakesoje apo te ndryshoje objektin e veprimtarise se saj .

Neni 7

Bashkimi i pjeseve te kapitalit themeltar te Shoqerise



nuk passjell shperberjen e Shoqerise .



Neni 8

Shoqeria ka te drejte te lene peng pjese te kapitalit themeltar te saj. Ne rast shitje te detyrueshme te pjeseve te lene peng, pengmarresi do te pranohet si person te cilit i jana transferuar pjese te kapitalit, me perjashtim te rasteve kur Shoqeria preferon t'i ribleje keto pjese e te deklaroje zvogelimin e kapitalit te saj themeltar .

Neni 9

Ne asnje rast shumica nuk mund te detyroje pakicen te shtojte angazhimin e tij ne kapitalin themeltar te Shoqerise

Neni 10

ORGANET E SHOQERISE

Organet e Shoqerise jane :

- Asambleja e ortakeve
- Keshillin administrativ .

ASAMBLEJA E ORTAKEVE

Neni 11

Asambleja e ortakeve te Shoqerise eshte organi me i larte dhe vendimor i Shoqerise. Vendimet e saj dhe ne

perputhje me statutin dhe me legjislacionin ne fuqi, jane te detyrueshme per ortakët, duke perjashtuar te drejten e tyre te ankimit kunder vendimeve qe ata i cmojne te demshme per interesat e tyre .



Neni 12

Asamblea e ortakëve mbledhet ne mbledhje te saj te pakten nje here ne cdo tre muaj dhe sa here qe ortakët e Shoqerise ndodhen te pranishem ne qendren e Shoqerise ose jashte saj me propozimin e secilit prej ortakëve .

Neni 13

Asamblea e ortakëve thirret nga njeri prej administratoreve te Shoqerise ose nga eksperti kontabel dhe mbahet rregullisht ne qendren e Shoqerise .

Thirrjet behen me shkrim dhe ju komunikohen ortakëve ne vendbanimet e tyre te pakten 15 dite perpara mbledhjes .

Neni 14

Cdo ortak mund te perfaqesohet ne mbledhjen e asamblese se ortakëve nga nje ortak ose person e trete, mjaft qe ata te mos jene nje nga administratorët qe jane thirrur ne mbledhjen e asamblese .

Mandati i perfaqesuesit verifikohet nga drejtuesi i mbledhjes .

Neni 15

Nje ortak nuk mund te ngarkoje nje perfaqesues votoje ne emer te nje pjese te kapitalit te tij, duke votuar ai vete ne emer te pjeses tjeter te kapitalit te tij.



Neni 16

Cdo ortak ka te drejten e nje vote per cdo pjese ne zoterim. Vendimet e asamblese se ortakeve te Shoqerise merren me vendim unanim te ortakeve .

Neni 17

Mbledhja e Shoqerise drejtohet nga administratori qe ka kerkuar te mblidhet asamblea e ortakeve te Shoqerise .

Neni 18

Asamblea e ortakeve zgjedh keshillin administrativ. Ne mbledhjet e saj asamblea e ortakeve shqyrton dhe vendos per ceshtje te tilla si, emerimin dhe shkarkimin, e administratoreve, eksperteve kontabel te autorizuar dhe likujduesve, miratimin e raporteve te administrimit dhe kontrollit, miratimin e llogarive vjetore, ndarjen e fitimit, ndryshimet e statutit, shtojcat ne kontraten e themelimit te Shoqerise, zvogelimin; zmadhimin apo ndryshimin e kapitalit themeltar te Shoqerise, zvogelimin e kapitalit themeltar tek te tretet, zgjatja apo zvogelimi i afatit te kohezgjatjes se aktivitetit te Shoqerise.

likujdimin e Shoqerise si edhe shndrimin e Shoqerise me shoqeri te nje forme tjeter .



ADMINISTRIMI I SHOQERISE, KESHILLI ADMINISTRATIV

Neni 19

Keshilli administrativ zgjidhet nga asamblea e ortakeve. Keshilli administrativ zgjedh administratorët që do t'a përfaqësojnë në marrëdhënie me të tretet. Shoqëria administrohet nga keshilli administrativ dhe administratorët e zgjedhur nga ky i fundit për t'a përfaqësuar në marrëdhënie me të tretet. Administratorët e zgjedhur për përfaqësim të tretet kanë dhe të drejtën e nënshkrimit në emër të Shoqërisë. Administratorë të Shoqërisë mund të zgjidhen edhe persona që nuk janë ortake të Shoqërisë .

Neni 20

Ata kanë një mandat të pakufizuar në kohë. Zgjedhje dhe shkarkimi i tyre bëhet me vendim unanimit të asamblesë së ortakeve .

Neni 21

Administratorët e zgjedhur për përfaqësim kanë të drejtën e administrimit në interes të Shoqërisë, që janë në përputhje me objektin e veprimtarisë së Shoqërisë, me përjashtim të atyre kompetencave që me ligj i janë lënë asamblesë së ortakeve .

Neni 22

Shoqeria merr persiper detyrimet qe rrjedhin nga aktet e nenshkruara nga administratoret e zgjedhur per perfaqesim tek te tretet , edhe ne ato raste keto kur nuk perfshihen ne objektin e veprimtarise se Shoqerise, me perjashtim te rasteve kur ajo provon se te tretet e dinin qe akti i administratorit tejkalon objektin e veprimtarise se Shoqerise, ose kur te tretet ne rrethana te caktuara nuk mund ta injoronin keto fakt .

Neni 23

Administratorit i ndalohet ta kontraktoje me Shoqerine ne cdo forme qofte .

Ai pergjigjet per veprimet e kryera ne kundersizim me ligjin, apo per faje te tjera te kryera gjata ushtrimit te detyres .

Pasojat e marreveshjeve te pamiratuara nga asamblea e ortakeve qe i sjellin dem Shoqerise, i ngarkohen administratorit .

Neni 24

Ortaket qe zoterojne te pakten 1/10 e pjeseve te kapitalit themeltar mund te kerkojne nga gjyqesiaht taktimin e eksperteve kontabel per verifikimin e nje operacioni apo te veprimtarise se Shoqerise ne pergjithesi .



Neni 25

Asambleja e ortakëve apo gjykta cakton ekspert kontabel, te cilet kane nje mandat prej gjashte muajsh .

VITI FINANCIAR, BILANCI DHE FITIMET

Neni 26

Viti financiar fillon me 1 janr dhe mbaron me 31 dhjetor te cdo viti kalendarik. Me kete rast administratorët e Shoqërisë bëjnë inventarin dhe llogaritë vjetore në bazë të disiplinës financiare dhe dispozitave mbi kontabilitetin si edhe hartojnë një raport me shkrim për administrimin . Bilancit i bashkohen :

- Një situacion për garancitë e dhëna nga Shoqëria .
- Një situacion për sigurimet e bera nga Shoqëria .

Keto dokumenta vihen në dispozicion të ekspertëve kontabel të paktën një muaj përpara mbledhjes së asamblesë së ortakëve.

Neni 27

Përderisa "rezerva e domosdoshme" të arrihe 1/10 e kapitalit themeltar, Shoqëria është e detyruar të depozitojë në fund të cdo viti 1/20 e fitimit të realizuar .

Neni 28



Pas miratimit te llogariye vjetore dhe evidentimit te ekzistences se fitimeve, asamblea e ortakëve përcakton pjesën që u takon ortakëve në formën e dividendëve mbi fitimin ose mbi fitimin. Fitimi që do të ndahet midis ortakëve në proporcion me pjesët e kapitalit themeltar që ata kanë avancuar, përbehet nga fitimi i vitit financiar, të cilit i janë zbritur shumat e lëna menjëherë për "rezervën e domosdoshme" dhe nga ana tjetër janë zbritur ose janë shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e mbartura nga vitet financiare të mëparshme .

Neni 29

Ortakët që i konsiderojnë dividendet jo në përputhje me fitimet e realizuara, kanë të drejtën që brenda 3 vjetëve t'ua reklamojnë këtë ortakëve të tjerë .

ZGJATJA E AFATIT TE VERRIMTARISE

Neni 30

Me përfundimin e afatit të përcaktuar në nenin 3 të këtij statuti dhe kontratës bashkëngjitur me të, zgjatja e afatit mund të bëhet vetëm në vendim të asamblesë së ortakëve.

Neni 31

Shoqëria , prishet me përfundimin e afatit të caktuar



ne nenin 3 te ketij statuti, me perjashtim te rasteve
behet zgjatja e afatit sipas nenit 30 te po ketij statuti
ose kur ka nje prishje te parakoheshme per arsyet e
parashikuara nga ligji .

Shoqeria nuk priset kur njeri nga ortakët falimenton,
behet i paafte per pune ose vdes. Njkohesisht Shoqeria mund
te priset ne rast se nuk ka efektivitet per nje periudhe
koha prej tre vjetesh .

MENYRA E LIKUJDIMIT TE SHOQERISE KUR AJO PRISHTET

Neni 32

Shoqeria hyn ne procesin e likuidimit qe ne momentin e
prishjes se saj. Per kryerjen e ketij procesi, asamblea e
ortakeve zgjedh likuidatorët, te cilet i paraqesin asaj
raportin mbi aktivin dhe pasivin e Shoqerise, mbi ndjekjen e
operacioneve dhe mbi afatin e nevojshem te likuidimit te
tyre. Gjithashtu likuidatorët per likuidimin e Shoqerise,
pervec normave te ketij statuti zbatojne detyrimisht edhe
normat e ligjit shqiptar ne fuqi dhe vecanerisht normat e
ligjit Nr.7638 dt.19.11.1993 "Per Shoqerite Tregetare"

DISPOZITA TE FUNDIT

Neni 33

Shndrimi i Shoqerise me pergjegjesi te kufizuar ne nje



shoqeri te nje lloji tjeter, behet gjithmone me pelqimin e
ortakeve te kesaj Shoqerie .



Neni 34

Te gjitha mosmareveshjet qe mund te lindin gjate
ekzistences se Shoqerise ose ndermjet periudhes se
likuidimit, midis ortakeve, midis Shoqerise dhe te treteve
si pale, do te paraqiten per zgjidhje ne Gjykatën e Rrethit
Tirane .

Neni 35

Marredhenjet e punes ne Shoqeri, rregullohen me
kontraten e punes .

Per ceshtje qe nuk rregullohen me kontraten e punes,
zbatohen dispozitat e legjislacionet shqiptar te punes. Kjo
eshte e njejte edhe per zyrat e perfaqesimit, agjensite,
filialet apo zyrat komisionere qe Shoqeria mund te hape me
vendim te asamblese se ortakeve .

Neni 36

Administratore te Shoqerise jane zoterinjte z.Adrian
Dulaku dhe z.Mateo Scalco

--O R T A K E T--

ADRIAN DULAKU

MATEO SCALCO